



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 30.05.2023

Nr: 164

Ora: 14:40

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 88, DATË 25.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA DREJTËSI, INTEGRIM DHE UNITET"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 30.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Subjekti zgjedhor "Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet", përfaqësuar nga z. Shkwlqim Sulo dhe z. Klardi Xhemali

OBJEKT: Kundërshtimi i vendimit nr. 545, datë 23.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Lezhë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023".

BAZË LIGJORE: Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar



Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Subjekti zgjedhor “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 88 regj., datë 25.05.2023.

Në mbledhjen e datës 30.05.2023, pas relatimit të z. Ledio Braho u konstatua se kërkesa ankimore nr. 88 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126 dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të Kodit Zgjedhor, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 88, datë 25.05.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 02.06.2023, ora 10:00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar